

Fjala përshëndetëse e Kryetarit të Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës akad. Mehmet Kraja në veprimtarinë e mbajtur nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë dhe Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës: përurimi i librit “Çesk Zadeja në muzikën shqiptare” (Jeta dhe vepra) me autor akad. Vasil S. Tole

Të nderuar miq, akademikë dhe të tjerë të pranishëm,

Më lejon të them që në fillim se botimi i veprës “Çesk Zadeja në muzikën shqiptare” e Vasil Tolës shënon një arritje të re në fushën e bashkëpunimit mes dy akademive tona, sepse nuk bëhet fjalë për ribotim veprash ose monografish shkencore, por për botimin e një dorëshkrimi origjinal, të pabotuar më parë, pasi te ne i është bërë vlerësimi nga profesionistët e fushës.

Deri tani ne kemi njohur bashkëpunim me ribotime, tani do ta avancojmë këtë bashkëpunim me botime veprash shkencore, të paraqitura në formën e dorëshkrimeve. Pra, ky është nivel tjetër i bashkëpunimit. Prandaj, i ftoj me këtë rast anëtarët e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë që në të ardhmen të sjellin veprat e tyre në dorëshkrim, që t’i botojmë në Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, sikundër që kërkoj që po këtë gjë ta bëjë edhe Akademia e Shkencave të Shqipërisë, me botimin e dorëshkrimeve të autorëve nga Kosova.

Arsye pse zgjodhëm këtë vepër ta botojmë si të parë në kuadër të këtij bashkëpunimi, janë dy: e para, është Çesk Zadeja si kompozitor nga më të shquarit e muzikës shqiptare, pra një kompozitor që i tejkalon kufijtë shtetëror dhe bëhet vlerë e gjithë kombit shqiptar; dhe e dyta, është autori, pra Vasil Tole, i cili ka dhënë dhe vazhdon të japë një kontribut të çmuar në fushën e muzikologjisë. Marrë në përgjithësi, ne kemi mungesë të literaturës muzikologjike, veçmas ne në Kosovë dhe kjo vepër krijon një model dhe i jep një shtysë studimeve të kësaj natyre.

Natyrisht, unë nuk jam profesionist i fushës dhe nuk dua të flas për vlerat dhe arritjet shkencore të veprës, as për muzikën e Zadesë, por më lejoni të them se, derisa për ju në Shqipëri vepra e Zadesë ishte muzikë me vlera të qëndrueshme, për ne në Kosovë muzika e Çesk Zadesë ishte identitet.

Dhe e tillë do të mbetet edhe për shumë kohë!

Ju faleminderit!

Tiranë, 9 qershor 2022